

Në një dokument të 8 tetorit 1709, të shkruar në Shkodër, përmenden për fundin e shekullit XV «Denku a Dimitri e Martusi»¹. Te ky dokument vëmendjen tonë e tërheq emri *Denk*, që këtu del për herë të parë e të vetme në një dokument shqiptar të shek. XVIII, që bën fjalë për fundin e shekullit XV. Simbas këtij burimi, i njëjti njeri del me dy emra: *Denk* e *Dimitër*; por, megjithëse është e tepërt ta themi, në mes këtyre emrave s'ka ndonjë lidhje etimologjike.

Botimi i Defterit të Sanxhakut të Shkodrës (1485) na bie një element të ri e të rëndësishëm, për zgjidhjen e kuptimit të këtij emri dhe për afrimin e tij me një emër tjetër të gjysmës së shek. XVI, atë të Bdek Buzukut, që është i ati i Gjon Buzukut (1555).

Si dihet, qëllimi i parë i atij Defteri, si edhe i Kadastrës së Shkodrës të përgatitur nga Venediku (1416-1417), ka qenë vetëm e vetëm fiskal. Aty janë regjistruar pronat shtetërore dhe emrat e kryefamiljarëve që do të shlyenin detyrimet feudale të caktuara nga pushteti në fuqi. Ndër kryefamiljarët që, më 1485, regjistroheshin në zonën e Drishtit dhe pikërisht në Domën, kemi tre pjestarë të së njëjtës familje. Domenik Kambisi (= Kambësi), Dimitër Kambisi dhe Gjergj Kambisi².

Se këta persona, për të cilat bëhet fjalë në Defter, më 1485, janë një me ata të dokumentit të vitit 1709, nuk është e vështirë të provohet. Kjo veçanërisht për njërin prej tyre, Dimitrin, që ne e identifikojmë po me Dimitrin e Defterit. Ndërsa Martusi nuk mund të barazohet me Gjergjin, vetëm në rast se ne shohim në emrin e parë një apelativ të dhënë këtij Gjergji³. Mbetet, më në fund vënia përballë e Denkut me Domenikun, gjë që na bind, për arsyet që do të rreshtojmë më poshtë.

Prandej, si në Defterin e 1485-s, ashtu edhe në dokumentin e vitit 1709, kemi të bëjmë me tre vetë e jo me dy, dhe fjalia «Denku a Dimitri» duhet të lexohet «Denku e Dimitri».

Edhe koha, në të cilën jetuan, del vetvetiu. Në dokumentin e tetorit 1709, simbas dëshmisë të Mark Pemës, Denku jetoi 32 vjet mbas pushtimit

1 Në mungesë të dokumentit origjinal, të dhënat i kemi nxjerrë nga përkthimi i tij i botuar te «Kalendari i vjetës 1926 (i Veprës Pijore). Shkodër, ff. 55-62 : «Përmbi shpë të moçme të Kamcejve të Shkodrës a ma mirë të Drishtit».

2 «Defter i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485». I. Tiranë 1974, f. 405.

3 Simbas gojëdhënëse që jepet në dokumentin e 1709-s, pasardhësit e Martusit u quajtën Merturi dhe u shpërngulën në Pult («Kalendari i vjetës 1926» *vep. e çek.*, ff. 55-56, 58 dhe 60).

të Drîshtit⁴. Pra, në qoftë se këto vite ia shtojmë vitit të rënies së Drîshtit në dorën e Turkut (1478), do të kemi se Denku ka vdekur më 1510. Kështu që është plotësisht e drejtë të pranojmë se ka qenë gjallë në vitin 1485 dhe, përfundimisht, se është i njëjti person.

1. Emrin *Denk* ne e shohim të rrjedhur nga një *Dominicus*. Në emrin latin *Dominicus* zanorja *o* e patheksuar, aty paratheksore e brendshme, dha *u*, sikurse në fjalë të tjera të zanafillës latine (*voluntàtem*>vullnet, *potestàtem*>pushtet, *consolàre*>ngushëlloj), dhe pastaj kjo *u* me gjithë tingullin *m*, duke qenë me vendesë para theksit, në emrin e mësipërm u zhduk, ndoshta thjesht për një arsye «konsumimi» ose shndërrimi, si ndodh rëndom në onomastikë⁵, ose për arsye të tjera që ne nuk po arrijmë t'i kapim.

Ndërsa zanorja latine *i* e theksuar te kjo fjalë dha *e*, ashtu si edhe te fjalët *fittera*, *sagìtta*. Kurse *i*-ja e patheksuar, duke u reduktuar në *ë*, si edhe zanoret e tjera të këtij pozicioni, më vonë bie si, p.sh., nga lat. *Cànticum* kemi *kanëk*, *kankë* (kângë/këngë), apo nga lat. *Mànica* kemi **manëk*, *mankë* (mangë/mëngë) simbas një ecunie të ngjashme.

Të gjitha këto na çojnë, më në fund, tek emri *Denk*, siç jepet në një dokument të 1709-s, i cili flet për fundin e shekullit XV.

2. Emrin *Denk* e krahasojmë tashti me emrin *Bdek*, emër i t'et të Gjon Buzikut.

Për kalimin nga trajta primare *Denk* në atë sekundare *Bdek* vërejmë: a) shtesën e elementit *b*, si protezë⁶, pa ndonjë funksion në kuptimin e fjalës; b) rënien e hundores *n* me të cilën kemi shkallën e fundit të zhvillimit të këtij emri, ku *e*-ja nuk u bë hundore, sepse nuk qe hundore, duke qenë se edhe fillimisht fjala, nga e cila e kishte burimin, përbëhej nga një zanore+*n* dhe jo nga një zanore hundore. Po të kishte qenë *e*-ja një hundore, atëherë do të kishte ndodhë afrimi i emrit *Denk* me foljen *bdek-unë*⁷, ose siç e ka Buzuku «*të mos bdesë*»⁸ që, për analogji, i dha emrit një *b* nistore duke sjellë ndryshimin e *Dek* në *Bdek*, siç e shohim te Buzuku. Është vënë në dukje

4 Kalendari... vep. e çek., f. 57.

5 Po japim një shembull tipik të shndërrimeve të cilave u nënshtrohen emrat vetjakë. Tipik është emri *Mari* që dha *Mëri*>*Mrí*>*Mrikë*>*Mrikushë*>*Kushë*>*Kushaqe*>*Shaqe*. Të gjithë këta emra të vërejtur ndër gra që jetuan në Shkodër deri në shekullin XX.

6 K. ASHTA, *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzikut (1555)*, I, në «Buletin shkencor» i Inst. Ped. Dvjeçar të Shkodrës, 1964, 1, f. 115.

7 E. ÇABEJ, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e shqipes*. II. Tiranë 1976, f. 232.

8 *Meshari* i Gjon Buzikut (1555). Botim kritik punuar nga E. Çabej, Pj. II. Tiranë 1968, f. 131 (XLV/2a).

se «Bogdani – e disa herë dhe Buzuku – për vokalet nazale ka vokal+n (...) prandaj nuk mund të thuhet nëse trajtat e Bogdanit (do të shtojmë: *edhe të Buzukut* – W.K.) duhet lexuar me vokal nazal apo me vokal+n»⁹. Për ne, këtu kemi një lexim zanore+n dhe rrjedhimisht një *e* jo hundore, e cila pati mundësi të qëndrojë e hapur në shqiptim edhe kur *n*-ja ra, duke e ruajtur këtë shqiptim të hapur, i cili e afronte, me *e*-në e foljes *bdek-unë*.

Ky është i dyti rast te Buzuku, të një *b*-je nistore e rrjedhur nga një metatezë, si, p.sh., në *bdjerrë* (nga *dbjerrë*), etj.

Përfundimisht provohet parësia e Denk-ut përkundrejt Bdek-ut, si trajtë më e vjetër e emrit t'et të Gjon Buzukut dhe të prejardhjes, pa kurrfarë dyshimi të të dy trajtave të emrit nga *Dominicus*, ashtu siç e kanë pohuar me kohë, për Bdekun, M. Roques¹⁰, J. Rrota¹¹, E. Çabej¹², K. Ashta¹³.

Te ky emër, në trajtat Denk e Bdek, ndoshta kemi një emër vendës¹⁴. Edhe në qoftë se do të pranojmë njëfarë përllyemeje (kontaminimi), këtë do ta shohim jo në mes një emri vendës me një latin, por të një foljeje vendëse me një emër vendës, të prejardhur nga emri latin.

Kështu emri *Denk*, në bazë të dokumentit të vitit 1709 (që flet për fundin e shek. XV), vërtetohet tashmë që më 1485, si një fazë më e hershme se ajo e emrit *Bdek*, i cili na dokumentohet nga Gjon Buzuku më 1555, por edhe që ky *Bdek*, së paku, i përket fundit të shek. XV.

**Ky kontribut asht botue ma s'parit te: «Buletin shkencor»
i Inst. të Lartë Pedag., Shkodër, XVII/1980, nr. 2, ff. 173-175.**

9 E. Çabej, *Hyrje...vep. e çek.*, f. 232.

10 M. ROQUES, *Recherches sur les anciens textes albanais*. Paris 1932, f. 10. Të shihet gjithashtu përkthimi shqip: *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe*, në «Buletin shkencor» i Inst. Ped. Dyvjeçar të Shkodrës, 1964, nr. i pos., f. 392.

11 J. RROTA, *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqipe. D. Gjon Buzuku (1555)*. Bot. i dytë. Shkodër 1938, ff. 8 e 17 n.1.

12 «Shenjt i Bdek: Meqë më sipër ka dhe Shenjt i Benedit, Bdek nuk mund të jetë identik me këtë emër, po e ka vendin e lat. *Dominicus*». («Meshari» i Gjon Buzukut (1555), *vep. e çek.*, nota në f. 51).

13 K. ASHTA, *Leksiku...*, *vep. e çek.*, f. 115.

14 Të këtij mendimi janë: M. Lambertz, *Bericht über meine linguistische Studien in Albanien*. Wien 1916, ff. 19-20 («Viele urarte Namen erben sie weiter. Die katholische Kirche muss sie gelten lassen, substituiert ihnen aber katholische Heiligennamen, mit denen jene sprachlich gar nicht zu tun haben. So wird ein Ded und Dod vom taufenden Priester dem hl. *Dominicus* als Namenspatron unterstellt. Aus *Dominicus* lassen sie die Namensformen aber nicht herleiten, es sind vielmehr alte Lallnamen»), i çekur edhe nga E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II. Tiranë 1976, ff. 404-405; K. Ashta, *Leksiku...*, *vep. e çek.*, f. 115, i cili pohon se «emri Bdek është krejt shqiptar: onomastika e veriut të Shqipërisë dëshmon për këtë»; E. Çabej, *Studime etim. ... vep. e çek.*, që vëren: «kontaminim të një emri vendës me një latin, një «*interpretatio latina*».

Abstract

Taking cue from a document from 1709 quoting another document from the 15th century with three Albanian names (Denku, Dimitri, Martusi) and comparing it with the tax register of Sanjak of Shkodra (1485) where the same names from the household Kamsi appear, the author focuses on the evolution of the Albanian names *Denk* and *Bdek*. The author diligently explains why these two names must have derived from the Latin name *Dominicus*, not from *Benedictus*.

Supported by sufficient persuasive data, the phonetic evolution processes mentioned here are fundamental to proving that *Denk* is a form older than *Bdek*.